

BULETINI I IGJK shkurt 2005

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK tani përmban artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë. IGJK në këtë vit do të ftojë gjyqësinë që të kontribuojnë në këtë buletin dhe të publikojnë artikujt apo raportet e tyre. Buletini i janarit gjithashtu përfshinë edhe mesazhin e posaçëm në vijim

Informata plotesuese paraprake per provimin hyres në gjyqësi dhe Programin Fillestar për Arsimim ligjor per kandidatet te cilet deshrojne te emrohen per poziten e gjykatesit apo prokurorit

Projekti për Ndërtimin Institucional të Institutit Gjyqësor të Kosovës është një projekt i financuar nga BE (nen udhëheqjen e Agjencionit Evropian për Rindërtim) dhe i zbatuar në partneritet, udhëhequr nga Transtec. Një nga partnerët tanë vendor është Qendra Juridike e Kosovës.

Një nga komponentët e Projektit, në bashkëpunim me akterët kryesor dhe pas miratimit nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës, është përgatitja e Provimit Hyres në Gjyqësi (PHGJ) dhe Programi fillestar për Arsimim Ligjor ("PFAL") për kandidatet të cilët duan të emërohen për postin e gjykatësit apo prokurorit.

Qëllimi i këtij programi është forcimi i procedurave të zgjedhjes dhe të emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë dhe të mundësohet përzgjedhja e kandidateve me të përshtatshëm për plotësimin e postit të gjykatësit dhe prokurorit.

Qe nga Maji i vitit 2004, Projekti është duke punuar në zhvillimin e Provimit Hyres në Gjyqësi dhe të PVAL. Pas shume konsultimeve të bëra me aktorët kryesor,

është formuar Grupi Punues, drejtuar nga Eksperti për Trajnime Gjyqësore në kuadër të projektit, Dr. Deville Rainer (Gjykatës Gjerman me një përvojë të konsiderueshme si gjykatës dhe trajnues i gjykatësve). Grupin Punues e përbejnë Zhivojin Jokanovic (KGJPK), Prof. Dr. Enver Hasani (Universiteti i Prishtinës), znj. Radostina Nedeva, zyrtare ligjore në sektorin për zhvillim profesional në Departamentin e drejtësisë dhe Rustem Qehaja (Trajnues në IGJK përgjegjës për provimin hyrës).

Bazuar në rekomandimet përfundimtare të Grupit Punues, Projekti serish beri disa konsultime me akterët kryesor dhe beri disa modifikime në përmbajtje.

Qe nga ajo kohe, Projekti i ka prezantuar Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial rekomandimet e veta për Provimin e improvizuar të Hyrjes në gjyqësi si dhe plan-programin e Programit Fillestar për Arsimim Ligjor me kërkesë për tu miratuar. Pas takimit të mbajtur me 15 Shkurt 2005, Këshilli aprovoi prezantimin e Provimit Hyres në Gjyqësi (PHGJ) si dhe PFAL në cilësinë e "pilot projektit provues".

Kjo nënkupton që në procesin e ardhshëm të emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, si pjesë shtese e kushteve formale për emërtimin e gjykatësve dhe prokurorëve të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/8 (2001), si pjesë e procesit të kontrollimit, KGJPK do të kërkojë nga të gjithë kandidatet që t'i nënshtrohen Provimit Hyrës në Gjyqësi. Kandidatet të cilët me sukses kalojnë provimin, do të kërkojnë që të I nënshtrohen trajnimit 3 mujor të Programit Fillestar për Arsimim ligjor që përfshin temat të prezantuara në Aneksin A.

Provimi Hyrës në Gjyqësi përbëhet nga:

Dita 1: testi me shkrim	Testi i Inteligjencës së përgjithshme
shume zgjidhje	Testi me shkrime
a me shkrim	Deklarata
Dita 2: provimi me gojë	Studimi i ndonjë rasti (prezantimi gojor)
me gojë	Provimi me gojë

Provimi Hyrës nuk duhet konsideruar si ri-provim i Provimit të Jurisprudencës dhe të gjithë kandidatet duhet ta kenë të kryer, si parakusht për të aplikuar për postin e gjykatësit apo prokurorit. E gjithë kjo ka për qëllim të vlerësojë aftësitë e kandidatëve për të aplikuar njohuritë e tyre juridike në rastet konkrete që të simulojnë efektivisht në praktike rolin e gjykatësit apo prokurorit dhe me kalimin nëpër PVAL, trajnimit praktik t'i mundësojë kandidatët e ri që të pajisen shumë më mirë në ushtrimin e detyrave të tyre si gjykatës apo prokuror. Provimi Hyrës do të vlerësojë përzgjedhjen e kandidatëve me shkathtësi praktike, si ato të udhëheqjes, ndërtimit ekipor dhe komunikimit.

Provimi Hyrës në gjyqësi i hartuar si I tille do të ketë me shume mundësi për vlerësim me adekuat të:

- (i) Njohuri Juridike Profesionale të kandidatëve;
- (ii) Aftësia për të përdorur njohuritë e tilla gjate kryerjes së detyrave të tyre;
- (iii) Aftësia për të kuptuar, analizuar dhe stilizuar rastet komplekse në mënyrë të duhur;
- (iv) Udhëheqja e kohës
- (v) Aftësive për udhëheqjen e rasteve
- (vi) Aftësive për të shkruar
- (vii) Aftësive të shprehjes gojore
- (viii) Aftësive për të kryesuar kolegjin gjyqësor.

Si plotësim I kësaj, provimi hyrës do të përqendrohet në dy çështje të cilat deri më tani nuk kanë qenë të përfshira e as të testuar në provimet e mëparshme. Këto janë aspektet e të Drejtave të Njeriut dhe Konventave Evropiane, pasi që është drejtpërsëdrejti e aplikueshme në bazë të Kapitullit 3 të kornizës kushtetuese filozofisë dhe etikës, duke qenë një ndër çështjet kryesore me të cilën do të merret gjyqësori.

Është propozuar që Provimi Hyrës në Gjyqësi të mbahet brenda dy ditëve. Ky provim është i përbërë prej tri testeve me shkrim: Testi themelor i inteligjencës (shih Aneksin A në të cilin janë dhënë shembuj për llojet dhe formën e pyetjeve të parashtruara në këtë pjesë), testi me shume zgjidhje me pyetje të përfshira nga të gjitha fushat e së drejtës (shih Aneksin B shembujt e dhënë për llojet e pyetjeve që janë të përfshira) dhe punimi me shkrim.

Testi për matjen e inteligjencës së përgjithshme është një test standard që është prezent në tregun për matjen e koeficientit të inteligjencës me theks të veçantë në shkathtësitë analitike. Ekspertët janë të vetëdijshëm se rezultatet e këtyre

testeve janë të kufizuara meqë kandidatet mund të marrin numër më të madh të pikave në trajnimet paraprake. Por të paktën me këtë test mund të sigurohen të dhëna se kandidati ka aftësi të përgjithshme të mësoj me sukses gjatë trajnimit fillestar dhe gjatë jetës së tyre profesionale.

Testi i dytë është **test me shkrim me zgjidhje të shumta**. Përparësia e testit është mundësia për të verifikuar njohuritë ligjore duke mos shpenzuar shumë burime në vlerësimin e rezultateve. Këto teste duhet të hartohen dhe të organizohen (që të vendosen me shumë persona në një sallë) dhe të bëhet vlerësimi i rezultateve. Kjo kërkon me shumë kohe dhe ka çmim më të lartë. E më tej e këtij testi është se i jep përparësi kandidatëve të cilët janë mësuar t'u nënshtrohen dhe të kalojnë këtë lloj testi edhe pse këto shkathtësi nuk kërkojnë në punën e tyre profesionale të gjykatësit apo prokurorit. Si plotësim i kësaj, testi me zgjidhje të shumëfishta bën matjen e të mësuarit të materies së ofruar por jo edhe të shkathtësive. Megjithatë kjo është një procedurë e dobishme. Testi me mundësi të zgjidhjeve të shumëfishta të këtij lloji, zakonisht ofrojnë katër përgjigje të ngjashme në mesin e të cilave vetëm një përgjigje është e sakte. Kandidatet, natyrisht se duhet të rrumbullakojnë përgjigjen e sakte, meqë kandidatet nuk mund të qëllojnë përgjigjen e saktë nga mendimi logjik. Pyetjet mund të përfshijnë të gjitha fushat e së drejtës dhe duhet të përqendrohen kryesisht në njohuritë nga praktika ku duhet përfshire edhe e drejta procedurale. Madje do të shtrohen pyetje shumë praktike, si p.sh baraspeshimi i interesave apo shpenzimet nga rastet civile që mund të jepen si pyetje plotësuese.

Pjesa e tretë e ditës së parë do të vazhdojë me **punime me shkrim** të zgjedhura nga temat e përgjithshme. Nga kandidatet do të kërkojë që brenda një ore kandidatet të shprehin mendimet e tyre lidhur me sistemin gjyqësor (Pse dëshironi të bëheni gjykatës apo prokuror? A është e shprehur nevoja për gjykatë të veçante

administrative?), Problem praktik në punët e përditshme në zhvillimet aktuale ligjore dhe politike (Çfarë pritni nga hapja e përfaqësisë së përhershme të BE në Kosovë? Pse standardet para statusit?) Apo në çfarëdo teme tjetër të përgjithshme. Qëllim i këtij deklarimi është testimi i aftësive të kandidatëve që të shprehin aftësitë e tyre me shkrim dhe të prezantojnë temën në një mënyrë të strukturuar dhe logjike.

Kandidatet të cilët kalojnë Pjesën e parë do të ftohen të hyjnë në pjesën dytë të provimit (që do të mbahet një ditë tjetër). Dita e dytë e provimit, fillon me prezantimin e kandidatëve kryetarit të panelit që bën vlerësimin. Ky do të jetë një rast për të shprehur zhvillimet e aftësive individuale në jetën e kandidatit. Kandidatet do të rreshtohen në grupe prej gjashtë vetave. Atyre do t'u dorëzohet rasti praktik që duhet të prezantohet në formë individuale para panelit që bën ekzaminimin dhe ata prezantohen në grupe të përbashkëta për të hyre në provim me gojë.

Në ushtrimin e prezantimit të rastit praktik secili kandidat do të marrë nga një rast nga praktika. Këto raste janë hartuar për qëllime të provimit. Do të jete 10 faqe në formë të një dosje. Kandidatet do të kenë një orë kohe për tu përgatitur. Kandidatët do të duhet të lexojnë materialin për rastin e dhënë, ta kuptojnë atë (dhe të demonstrojnë se e kanë kuptuar atë provat dhe çështjet e shtrura) dhe të prezantojnë me gojë provat dhe zgjidhjet praktike të rastit brenda dhjetë minutave para panelit që bën vlerësimin. Ky ushtrim ka për qëllim të bëjë vlerësimin e njohurive të ligjeve, vlerësimin e aftësisë së kandidatëve për të kuptuar rastet e ndërlikuara duke demonstruar njohuri të tilla, bënë vlerësimin e kapacitetit të tyre për të dalluar rastet dhe provat kontestuese dhe jo-kontestuese, faktet relevante dhe jo-relevante, testimin e aftësive praktike të punës dhe të prezantimit me gojë.

Më pas vazhdon pjesa e **ekzaminimit gojor** e të njëjtit grup. Secili pjesëmarrës i

panelit mund të bëjë pyetje nga një lëmi e se drejtës (civile, penale, publike). Çdo vlerësim edhe i ndonjë fushe te veçante ekzaminohet ne kuadër te këtyre lëmvive (p.sh. e drejta e punës si pjese e te drejtës civile, e drejta e BE si pjese e te drejtës qe do te thotë një ore ne një fushe te se drejtës me gjashte kandidate te pyetur.

Kandidatet te cilët kalojnë Provimin Hyrës në gjyqësi pastaj kërkohen qe t'i nënshtrohen Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL). Orari i parapare dhe përmbajtja e PVAL është bashkangjitur si Aneksi (C). Programi PVAL fillimisht do te ushtrohet si pilot projekt provues per 3 muaj (edhe pse Ligji për IGJK (nëse aprovohet gjate kësaj kohe) ofron mundësi të ngjashme qe PVAL te zhvillohet për 10 muaj). Qëllimi i PVEL është qe t'ju ofroj kandidateve trajnim nga praktika ne fusha specifike te se drejtes dhe praktikes gjyqsore: sidomos nga e drejta penale dhe e procedurës penale; te drejten civile dhe

publike). Kjo është një mundësi për te bere pyetje standarde te shfrytëzuara nga KGJPK edhe më parë dhe për te shtruar pyetje te lira për gjyqësorin. Secili kandidat, zakonisht intervistohet rreth dhjete minuta ne te tri fushat e se drejtës, procedurën civile; studimin e rasteve dhe të udhëheqjes; shkathtësitë e shkrimit / hartimit te teksteve; aspektet praktike te Konventës Evropiane për te Drejta e Njeriut; Sjellja Profesionale dhe Etika, simulimi i rolit te gjykatësit dhe prokurorit.

Po ashtu shpresohet qe kandidatet te cilët me sukses kompletojnë te dy pjesët, si te Provimit Hyrës njashtu edhe te PVAL do t'u ofrohet mundësia qe te marrin pjese ne ushtrimin e praktikes prej 4-6 jave ne ndonjë Zyre te Gjykatës apo Prokurorisë te ndonjë shteti anëtare te BE-së. Tani po bëhen përpjekje për gjetjen e fondeve për ketë qellim.

Programi i Aktiviteteve për mauajin Shkurt, 2005

Seminar mbi Ligjin Kundër-Diskriminimit

Me datën 07, dhe 08, shkurt, 2005, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim OSBE-në kanë organizuar një seminar rreth parimeve kundër-diskriminimit, ky sesion trajnimi ju adresohet gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të gjitha regjionet e Kosovës. Ligji kundër Diskriminimit është nxjerr së voni dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2004, pasi qe ky Ligj është i ri në Kosovë, ky Seminar ka për qëllim t'i njoftoj gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës lidhur me çështjet e Diskriminimit nga sektori publik dhe privat. 26 pjesëmarrës e përcollën këtë seminar gjatë dy ditëve. Ndër ta ishte një gjyqtar nga radhët e minoritarëve.

Seminar mbi Shkencën dhe Teknologjinë në Gjykata.

Me datën 10, shkurt, 2005 Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar një seminar lidhur me temën e lartpërmendur i cili ka pasur për qëllim harmonizimin e praktikës gjyqësore në lidhje me kryerjen dhe ndikimin e ekspertizave në procedurat gjyqësore. Në këtë seminar u ftuan ekspertet nga gjyqësori SHPK-ja dhe organizatat shkencore për të prezantuar temat përkatëse. Në këtë seminar morën pjesë nëntëmbëdhjetë pjesëmarrës; të gjithë ishin të përkatësisë shqiptare.

Tryezë e diskutimeve rreth Mbrojtjes Ligjore

Kjo tryezë ishte vazhdimësi e diskutimeve lidhur me problemet të cilat paraqesin paqartësi dhe kundërshtime në aplikimin e Kodeve të reja penale. Kjo tryezë diskutimesh është organizuar nga IGJK në bashkëpunim me

Shoqatën e Gjyqtarëve të Prokurorëve dhe Odën e Avokatëve të Kosovë. Gjithsej njëzet e gjashtë pjesëmarrës ishin prezent në këtë tryezë diskutimesh të gjithë të përkatësisë shqiptare.

Seminar mbi Harmonizimin e Praktikës Gjyqësore nga lëmia civile

Ky seminar ka pasur për qëllim të ofroj informacione lidhur me zhvillimet e fundit rreth rregulloreve dhe legjislacioneve të reja nga lëmia civile në Kosovë të cilat janë në pritje për t'u nxjerrur. Pastaj pjesëmarrësit e këtij seminari patën mundësin të marrin pjesë në ushtrimet grupore për shqyrtimin e disa rasteve praktike në mënyrë që të mundohen ta harmonizojnë praktiken e tyre në disa raste më të shpeshta nga e drejta civile. Numri i pjesëmarrësve në seminar ishte gjithsej 15. Një nga pjesëmarrësit ishte i përkatësisë minoritare Serbe.

Tryezë e diskutimeve për Gjykatat e Kundërvajtjeve

Kjo tryezë ishte vazhdimësi e tryezave të këtij lloji, me titull të njëjtë ofruar nga

IGJK-ja për gjyqtarët e Gjykatave për Kundërvajtje. Numri i pjesëmarrësve ishte gjithsej 17 gjyqtar të gjithë shqiptar.

Seminar mbi Mbrojtjen e Dhunës Familjare

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka ofruar një seminar rreth implementimit të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12, *Mbrojta kundër Dhunës në Familje*. Për arsye se anëtarët e gjyqësisë kanë treguar një interes të madh rreth kësaj çështje, IGJK ka përfshirë këtë temë në programin e saj vjetor për vitin 2005. Ky program adreson përgjegjësitë e gjykatave të cilat kanë juridiksion mbi këto raste. Numri i pjesëmarrësve në këtë seminar ishte 21-16 gjyqtar, 4 prokuror dhe një avokat. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të përkatësisë shqiptare.

Aktivitetet e ardhshme

Tryezë diskutimesh rreth Ligjit Komercial
Grupi përfitues: gjyqtarët që gjykojnë rastet civile dhe ekonomike.

Kjo punëtori do të prezantoi pjesëmarrësve dilemat që hasen më së shpeshti gjatë praktikës gjyqësore që kanë të bëjnë me kontratat afariste, shitblerjet dhe shitjes së mallit me të meta. IGJK ka ftuar si trajnues disa nga praktikuesit më të mirë në fushën e lighit komercial në Kosovë. Kjo tryezë e diskutimeve ka për qëllim iniciimin e diskutimeve profesionale në mes të gjyqtarëve që shqyrtojnë rastet nga lëmia

ekonomike nga të gjitha instancat në mënyrë që të ndihmohet dhe harmonizohet praktika nëpër gjykata në rastet ekonomike.

Data e planifikuar: 9 mars 2005.

Punëtori nga Ligji Penal për të Mitur

Grupi përfitues gjyqtarët që gjykojnë rastet me të mitur dhe prokurorët

IGJK në bashkëpunim me Shoqatën e gjyqtarëve, atë të prokurorëve dhe odën e avokatëve ka planifikuar të organizoi sesionin e dytë trajnues rreth ligjit të ri për të mitur. Qëllimi i kësaj punëtorie është që të paraqes analizat rreth implementimit të ligjit të ri dhe të përmirësoi koordinimin dhe

bashkëpunimin e të gjithë akterëve të përfshirë në procedurat e këtij ligji. Pjesëmarrësit do të mundohen të identifikojnë dhe diskutojnë se si shprastirat dhe kundërthëniet rreth disa dispozitave të ligjit të ri mund të zgjidhen në praktikë.
Data e planifikuar 10 dhe 11 mars 2005.

Seminar: Interpretimi dhe zhvillimi i Ligjeve civile :

Grupi përfitues: Gjyqtarët që gjykojnë rastet civile. Ky seminar ka për qëllim informimin rreth zhvillimeve të fundit rreth ligjeve në pritje për miratim nga lëmija civile. Pjesëmarrësve do të iu jepet mundësia që të marrin pjesë në ushtrime grupore rreth rasteve praktike të cilat do të zgjidhen në bazë të interpretimit të ligjit të aplikueshëm. Pjesëmarrësit do të kanë mundësinë që të dëgjojnë komente dhe interpretime të ligjeve civile nga profesorët e universitetit, praktikuesit vendor, gjyqtarët.
Data e planifikuar: 15 mars 2005.

Kursi fillestar për gjyqtarët porotë

Grupi përfitues: gjyqtarët porotë të sapoemëruar.

Në mars të vitit 2005 IGJK do të filloi një cikël të programeve trajnuese për gjyqtarët porotë i cili do të mbahet në pesë rajonet e Kosovës. Sesioni i parë njëditor do të mbahet në Prishtinë ndërsa sesionet tjera do të jenë në Prizren, Gjiilan, Pejë, dhe Mitrovicë. Programi fillestar i trajnimit ka për qëllim që të siguroi një pasqyrim themelor të funksioneve dhe përgjegjësive të gjyqtarëve porotë në të dy fushat atë penale dhe civile, si dhe do të përmbajë në vete edhe aspekte etike për pozitën e gjyqtarit porotë.

Datat e planifikuara:

17 mars 2005 – Prishtinë

14 prill 2005 – Pejë

15 maj 2005 – Prizren

16 qershor 2005 – Gjiilan

7 korrik 2005 Mitrovicë

Tryezë diskutimesh nga Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës

Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët që gjykojnë rastet penale

IGJK në bashkëpunim me shoqatën e gjyqtarëve atë të prokurorëve dhe odën e avokatëve të Kosovës do të organizojnë një punëtori rreth kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës. Për gjyqtarët dhe Prokurorët në nga rajoni i Mitrovicës. Kjo punëtori do të përqendrohet në Konfirmimin e Aktakuzës. Pjesëmarrësit do të kenë ushtrime praktike dhe diskutime në mënyrë që t'i tejkalojnë vështirësitë më të shpeshta me të cilat ballafaqohen gjyqtarët dhe prokurorët kur ata bëjnë seancën e konfirmimit të Aktakuzës në procedurën penale.

Data e planifikuar: 23 dhe 24 mars 2005.